



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 4 , datë 12.10. 2012

PËR

MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES PËR PËRDORIM ME KONCENSION TË BURIMIT “SASAJ, BUNEC” NË KOMUNËN LUKOVË, SARANDË”

Në mbështetje të nenit 6, pika “ë” dhe të nenit 18, të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për Rezervat Ujore” me propozimin të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Vjosë dhe ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të dhënies për përdorim me koncesion, të burimit ujqor “Sasaj, Bunec”, Komuna Lukovë, Sarandë, një pjesë e ujërave e të cilit do të përdoren për konfeksion dhe për eksport.

Specifikimet e burimeve ujore janë koordinatat, si më poshtë:


X	Y	Z
44 31 146, 44	44 06 531	42 m

2. Sasia e ujit që jepet për përdorim është:

- 50 l/sek për periudhën ujëpakët 15 Qershor – 30 Tetor dhe
- 200 l/sek për periudhën 1 Nëntor – 15 Qershor.

3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave dhe Këshilli i Basenit Ujembledhës Vjosë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Fatmir MEDIU
Zy/Kryetar i K KU
dhe

Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave


KRYETARI
Sali BERISHA

Flamur NOKA




Minister i Brendshem

Ridvan BODE

Minister i Financave

Edmond HAXHINASTO




Minister i Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes

Vangjel TAVO

Minister i Shendetsise


Genc RULI



Minister i Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit

Sokol OLLDASHI

Minister i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit



RELACION

PER

MIRATIMIN NE PARIM TE DHENIES PER PERDORIM ME KONCENSION TE BURIMIT "SASAJ, BUNEC" NE KOMUNEN LUKOVE, SARANDE

Shoqeria "Blue Eye One" sh.p.k, me perfaqesues ligjor Znj Sofie Merkaj, ka aplikuar prane A.U.B Vjose, me 18.07.2011, per perdorim te nje sasie prej 250 l/sek, te ujerave te burimit "Sasaj", per konfeksionim dhe eksport.

Ne funksion te ketij aktiviteti, shoqeria ka bere investigimet dhe studimet e nevojshme per vleresimin e fizibilitetit te ketij projekti.

Referuar kerkeses, ne baze te VKKU, nr 1, dt 03.03.2005, mbi "Kopetencat e Autoritetit te ujit per miratim lejesh dhe koncesionesh ne funksion te qellimit te perdorimit dhe sasise se ujit, percaktohet qe:

- Per konfeksion nga 5 – 300 l/sek dhe
- Per eksport nga 0 – 500 l/sek,

i takon KKU, per procedura te metejshme per pajisjen me leje koncesionare, pas miratimit ne parim nga KBU perkatese.

Ne zbatim te kriterëve te VKKU Nr 1, date 3.3.2005 dhe te kerkeses se subjektit "Blue Eya One" sh.p.k, KBU Vjosë në mbledhjen e tij të radhës, nëpërmjet vendimit Nr.12, datë 23.07.2012 "*Për miratimin në parim të kërkesës, për përdorimin me koncesion, të formës BOT, të burimit ujqor, "Sasaj", Bunec, komuna Lukovë, "Për imbotilim dhe eksportim të ujit të pijshëm"*, miraton sasinë prej 200 l/sek dhe ia propozon KKU-së për miratim.

Referuar dokumentacionit teknik te praktikës, studimit hidrogjeologjik perkates, rezulton se Q_{max} eshte ne nje sasi prej 914 l/sek, ne muajin Shkurt dhe Q_{min} 86 l/sek, ne muajin Gusht.

Qëllimi dhe synimi i politikës së qeverisë shqiptare është të sigurojë me tepër qëndrueshmëri, barazi dhe efikasë në menaxhimin e ujërave si dhe në përdorimin e ujit, bazuar në principet, uji si rezervë e kufizuar dhe uji si një e mirë ekonomike.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstatohet, se burimi ka prurje më të vogla se sasia e kërkuar prej 200 l/s në gati 4 – 5 muaj të vitit duke arritur minimumin mesatar në muajin Gusht me sasinë 86 l/s.

Analiza e Drejtorise Teknike u mbeshtet gjithashtu ne dy dokumenta te rendesishem te ketij dokumentacioni qe jane, miratimi nga ana e Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve dhe nga Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, Drejtoria Hidroenergjitike, per perdorimin e ketyre ujerave per konfeksion dhe eksport, pasi nuk perbenin objekt kerkesash apo projektesh nga ana e tyre per vepra dhe perdorime te ngjashme te ujerave, ne kete burim.

Sa më sipër, duke parë studimin hidrogjeologjik të paraqitur nga kompania, si dhe efikasitetin për përdorime të tjera sipas nevojave të komunitetit përkatës, mendojmë të miratojmë :

- 50 l/sek për periudhën ujëpakët 15 Qershor – 30 Tetor
- 200 l/sek për periudhën 1 Nëntor – 15 Qershor.

Sasia e mbetur e ujit do të parashikohet të përdoret për nevoja të tjera të komunitetit dhe aktiviteteve ekonomiko turistike dhe bujqesore në këto zone, duke marrë parasysh gjithashtu dhe fenomenin e thatësirave të mëdha që mund të ndodhin, si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Me respekt,

Fatmir MEDIU

Zv/Kryetar i K.K.U

dhe



Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave